


ProCredit Bank

ProCredit


Zero Neto

www.procreditbank-kos.com
BULETINI, Q3/2024

Çfarë është zero neto?

Zero neto përkufizohet si arritja e një gjendjeje në të cilën emetimet e gazrave serrë nga aktivitetet brenda zinxhirit të vlerës së një kompanie nuk kanë asnjë ndikim neto në klimë. Kjo arrihet duke reduktuar emetimet e gazrave serrë

në zinxhirin e vlerës sipas skenarëve 1.5° C dhe duke kompensuar ndikimin e mbetur të gazrave serrë përmes reduktimit përkatës të CO₂.



Zero neto deri në vitin 2050

Banka ProCredit është zotuar të arrijë nivelin zero neto deri në vitin 2050. Kjo përfshin reduktimin e emetimeve tona vetanake (Fushëveprimi 1 dhe 2), si dhe të atyre që lidhen me portofolin tonë të kredive (Fushëveprimi 3, kategoria 15).

Për t'u përafëruar me skenarin prej 1.5° C të përshkruar në Marrëveshjen e Parisit, ne kemi zhvilluar një Strategji për Veprim Klimatik, e cila do të çonte në një reduktim prej të paktën 90% të emetimeve tona të Fushëveprimit 1, 2 dhe 3 deri në vitin 2050. Për këtë qëllim, kemi përcaktuar objektiva afatshkurtra dhe afatmesme të bazuara në shkencë dhe të konfirmuara nga "Science Based Targets Initiative (SBTi)".




Çfarë janë emetimet e Fushëveprimit 1, 2 dhe 3? (shih ilustrimin më lart)

Cilat janë dallimet ndërmjet neutralitetit të karbonit dhe zero neto?



CARBON NEUTRAL

K.



NET ZERO

Neutral në karbon	Dallimet	Zero Neto
Një aktivitet (ose kompani) quhet “neutral në karbon” kur po e njëjta sasi e karbonit ose e gazrave serrë (GHG) e emetuar nga aktiviteti ose aktivitetet kompensohet plotësisht.	 Përkufizimi	Zero neto nënkupton pakësimin e të gjitha emetimeve të karbonit dhe GHG-ve deri në masën e mundshme, përmes masave të efijencës, elektrifikimit, burimeve të ripërtërishme etj. Vetëm emetimet thelbësore që mbeten kompensohen në fund.
Vetëm Fushëveprimi 1 dhe 2 Merren parasysh vetëm operacionet vetanake dhe nuk zbutet ndikimi në zinxhirin furnizues. Reduktimi i emetimeve nuk kërkohet në këto fushëveprime.	 Fushëveprimet e emetimeve	Fushëveprimi 1, 2 dhe 3 Merren parasysh operacionet vetanake dhe ndikimi në zinxhirin furnizues. Reduktimi i emetimeve është i detyrueshëm në të gjitha këto fushëveprime.
Kompensimet e reduktimit të karbonit, siç janë investimet në fermat e erës dhe/ose centralet fotovoltaike (PV), pakësojnë emetimet e ardhshme; por nuk i heqin realisht GHG-të nga atmosfera.	 Llojet e kompensimeve	Vetëm kompensimet që heqin karbonin, siç janë investimet në kapjen industriale të karbonit dhe pyllëzimin, konsiderohen zero neto.

Pse avancuam nga neutraliteti i karbonit në zero neto?

Duke ndjekur praktikat më të mira aktuale dhe këshillat e SBTi¹, vendosëm t'i avancojmë objektivat tona për neutralitetin në karbon dhe të përcaktojmë një plan tërësisht të strukturuar për të arritur nivelin zero neto deri në vitin 2050.

A e dinit se termi “neutraliteti në karbon” (ang: carbon neutrality) konsiderohet pretendim mjedisor mashtrues dhe ndalohet nga BE-ja?



Çfarë po bëjmë për të reduktuar emetimet e Fushëveprimit 1 dhe 2?

Ne po:

- **Masim dhe monitorojmë emetimet e CO2 lidhur me** operacionet tona (Fushëveprimi 1 dhe 2), që kryesisht burojnë nga energjia elektrike, ngrohja dhe përdorimi i automjeteve.
- **Rrisim pjesën e energjisë së ripërtërishme që konsumojmë**, përmes investimeve në sistemet tona fotovoltaike dhe furnizues të energjisë së pastër.
- **Rrisim përdorimin e automjeteve elektrike**: Që nga viti 2023, 61% e makinave në flotën tonë janë elektrike.
- **Zbatojmë masa për efikasitet energjetike në objektet tona**: zyrat qendrore në gjashtë prej vendeve ku ne operojmë janë vlerësuar me certifikimin e ndërtesës së gjelbër EDGE.

Çfarë po bëjmë për të reduktuar emetimet e Fushëveprimit 3?

Ne po:

- **Inkurajojmë tranzicionin e klientëve tanë**: Ne mbështesim përpjekjet e tyre për dekarbonizim përmes llogaritjes së karbonit dhe vendosjes së caqeve, si dhe u ofrojmë mbështetje financiare për zbatimin e strategjive përkatëse.
- **Rrisim mbështetjen për investime të gjelbra**: Ne synojmë të arrijmë 25% të investimeve të gjelbra në portofolin tonë të kredive në planin afat-mesëm, duke përfshirë pajisje me efikasitet energjetike, sisteme PV dhe ndërtesa të gjelbra, ndër të tjera.
- **Promovojmë energjinë e pastër**: Jemi të përkushtuar të bëhemi partneri kryesor financiar për dekarbonizim në vendet ku operojmë, përmes financimit të projekteve në energji të ripërtërishme.
- **U japim përparësi aktiviteteve me pak karbon**: Përmes zbatimit të kritereve strikte mjedisore dhe sociale në kredidhënie, ne orientojmë rritjen e portofolit të kredisë për biznese drejt aktiviteteve me më pak emetime karboni.

¹ Science Based Targets initiative (SBTi) është një partneritet ndërmjet CDP, Paktit Global të Kombeve të Bashkuara (UN Global Compact), World Resources Institute (WRI) dhe World Wide Fund for Nature (WWF). Kjo nismë nxit veprimet ambicioze për klimën në sektorin privat duke u mundësuar organizatave të përcaktojnë caqet për uljen e emetimeve, duke u bazuar në shkencë.